

VENDIM
Nr. 4, datë 13.1.2022

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR KËRKESËN E SHOQËRISË
“E.T.H-H” SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 205, SERIA PV12K, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 164/1 prot., datë 29.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi mosfillimin e procedurës për kërkesën e shoqërisë ‘E.T.H-H’ sh.p.k. për modifikimin e licencës nr. 205, seria PV12K, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “E.T.H-H” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1152/1 prot., datë 17.12.2021, ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, nga 1300 kw në 1580 kw në total për HEC “Helmes 1” dhe “Helmes 2”.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 349/5 prot., datë 6.10.2017, për miratimin e projektit të zbatimit dhe oponencën teknike nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) me shkresën nr. 5123 prot., datë 23.6.2017.

- Shoqëria “E.T.H-H” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 205, seria PV12K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 117, datë 22.8.2012.

- Shoqëria nuk ka kryer pagesën e aplikimit në llogari të ERE-s, për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të nenit 8, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në të cilin citohet se: “Aplikuesi duhet të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, përcaktuar në aneksin ‘A’, të kësaj rregulloreje”.

- Në kushtet kur nuk është kryer pagesa e aplikimit nga shoqëria, dokumentacioni i pjesshëm i depozituar bashkëlidhur kësaj kërkesë nuk mund të merret në shqyrtim nga ana e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “E.T.H-H” sh.p.k. me nr. 205, seria PV12K në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti